



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Nr. 63/2024

Datë: 16.07.2024

Bazuar në nenin 26, nenin 27, nenin 29, paragrafi 1, me nën paragrafi 1.1, 1.2, nenin 35, nenin 36 paragrafin 6, nenin 39, nenin 55 paragrafi 2 me nën paragrafi 2.4 dhe nenin 66 paragrafi 1 me nën paragrafin 1.8 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës (*Gazeta zyrtare Nr. 14/7 e dt. 07.06.2022*), Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2023 për Përcaktimin e Tregut Relevant si dhe Rregulloren Nr. 01/2023 për Procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me datën 12.07.2024 merr këtë:

KONKLUZION

Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun relevant, bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, konstatojmë se nuk ka argumente/kushte për fillimin e Procedurës Hetimore ndaj Grupit të Hosteleve në Komunën e Prishtinës, sipas nenit 36 paragrafi 6 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Arsyetim

Iniciativa për fillimin e procedurës:

Autoriteti i Konkurrencës me datë 20.03.2024 ka pranuar një ankesë nga grupi i hosteleve, me përfaqësues lidhur me çmime të dyshimta të ofruara në akomodim në Prishtinë. Grupi argumenton se kjo praktikë mund të jetë pjesë e një karteli për dëmtimin e konkurrencës në sektorin e turizmit dhe hotelierisë.

Bazuar në nenin 30, nenin 35 paragrafi 1 dhe nenin 39 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës 08/L-056, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka autorizuar grupin e punës për të siguruar të dhënat e nevojshme për shqyrtimin paraprak të rastit në fjalë.

Pretendimet e palës ankuese:

Grupi i hosteleve, me përfaqësues ka paraqitur kërkesë në Autoritetin e Konkurrencës për hetimin e operatorëve të dyshimtë të hosteleve në Komunën e Prishtinës. Sipas tyre, disa operatorë ofrojnë shërbime të akomodimit jo-legjitim me çmime shumë të ulëta prej dy (2) euro për fjetje një-ditore, që mund të jetë pjesë e një karteli për dëmtimin e konkurrencës dhe eliminimin e bizneseve të tjera.

Grupi ankues thekson rëndësinë e tyre për turizmin dhe hotelierinë në Prishtinë, duke shërbyer kryesisht të rinjtë me shërbime akomodimi dhe aktivitete të ndryshme. Ata kanë bashkangjitur prova në formë të screenshots dhe dëshmi financiare që tregojnë pamundësinë ekonomike të ofrimit të çmimeve kaq të ulëta në mënyrë legjitime, duke argumentuar se çmimi minimal për mbijetesë financiare është 8.00 euro për shtrat.

Grupi kërkon ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës për të adresuar këtë situatë dhe për të mbrojtur bizneset e tyre nga rreziku i falimentimit për shkak të konkurrencës së pandershme. Ata nuk kanë paraqitur ankesa të ngjashme në të kaluarën.

Aktivitet e zhvilluara ne shqyrtimin e monitorimit paraprak të tregut përkatës dhe korniza ligjore:

Më 20.03.2024, hostelët Hostel Oda SH.P.K, Prishtina Center Hostel SH.P.K, Hostel Prishtina Backpackers, GOT Prishtina Hostel dhe Come In Prishtina Hostel, paraqitën një ankesë kundër Newborn Center Hostel, Center House Hostel, Moonlight Hostel, City Park Hostel dhe Balkanlarda Hostel.

Me datë 05.04.2024, grupi i punës zhvilloi takime me Newborn Hostel dhe Center House Hostel. Gjatë takimeve, Hostel Newborn deklaroi se çmimet e tyre variojnë nga 7.00-8.00 euro gjatë sezonës dhe 4.00 euro jashtë sezonës për një hapësirë prej 85 m² me 2-3 dhoma. Center House Hostel deklaroi se çmimet e tyre variojnë nga 6.00-10.00 euro për një hapësirë prej 70-75 m².

Më 12.04.2024, grupi i punës vizitoi City Park Hostel, i cili deklaroi çmime prej 6.00-12.00 euro për shtrat. Më 30.04.2024, grupi vizitoi Moonlight Hostel SH.P.K, ku pronarja deklaroi çmime prej 7.00-25.00 euro për shtrat dhe se nuk mund të ofrojë çmime nën 5.00 euro.

Më 15.05.2024, përfaqësuesi i grupit ankues informoi se çmimet e tij nuk kanë qenë kurrë më të ulëta se 8.00 euro dhe se çmimi minimal i ofruar deri tani është 9.30 euro. Sipas tij, çmimet nën 5.00 euro janë të paqëndrueshme për fitim. Çmimet e sezonës për hostelin e tij janë 15.00-20.00 euro dhe jashtë sezonës planifikon të mos jetë aktiv për shkak të mungesës së vizitorëve.

Latifi theksoi se nga çmimi i rezervimeve në Bookings, 15% shkon për shërbimet e Bookings, 9% për tatim dhe 3% për bankën nëse përdoret POS. Kështu, nëse hostelët ofrojnë çmime prej 2.00 euro për shtrat, fitimi është rreth një (1) euro ose më pak.

Analiza e Konkurrencës:

Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është ruajtja dhe nxitja e konkurrencës efektive në treg për të siguruar një ambient të drejtë dhe të barabartë për të gjitha ndërmarrjet. Ky qëllim synon të parandalojë dhe të minimojë kufizimet që sektorët privat dhe publik mund të vendosin mbi konkurrencën, duke garantuar që tregu të operojë në mënyrë të lirë dhe pa pengesa të panevojshme.

Ligji i për Mbrojtjen e Konkurrencës ndalon praktikant antikongkurrencë që përfshijnë marrëveshje për fiksimin e çmimeve, abuzimin me pozitën dominuese në treg, si dhe çdo veprim që mund të krijojë ose të rritë një pozitë dominuese në një sektor të caktuar.

Autoriteti i Konkurrencës, si organi përgjegjës për zbatimin e politikave të konkurrencës, intervenon kur ka dyshime për shkelje të këtyre rregullave. Autoriteti i Konkurrencës vepron në bazë të ligjit për të mbrojtur konkurrencën e lirë, duke hetuar dhe ndëshkuar marrëveshjet e ndalura, kartelizimin dhe sjelljet e koordinuara që ndikojnë negativisht në konkurrencë dhe në tregun përkatës.

Përveç hetimit dhe ndëshkimit të shkeljeve të ligjit të konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës ofron udhëzime dhe këshilla për ndërmarrjet dhe konsumatorët për të rritur ndërgjegjësimin rreth rregullave të konkurrencës dhe rëndësisë së një konkurrence të lirë dhe të drejtë në treg.

Duke u bazuar në informatat e mbledhura gjatë takimeve të zhvilluara me pronarët dhe menaxherët e bizneseve si dhe informatave që figurojnë në Booking, grupi i punës nuk ka arritur që të faktojë pretendimet e palës ankuese për çmimin e shërbimeve të akomodimit, pasi që çmimet të cilat i ofrojnë nuk përkojnë me pretendimet e palës ankuese.

Marrëveshjet Horizontale mund të kufizojnë konkurrencën, veçanërisht nëse ato lidhen me çmimet ose ndarjen e tregut, ose nëse fuqia në treg e fituar si rezultat i bashkëpunimit horizontal ka efekte negative në treg për sa i përket çmimit, prodhimit, inovacionit ose larmisë dhe cilësisë së produktit.

Andaj, kjo situatë nuk rezulton në krijimin e ndonjë marrëveshje të ndaluar (kartel) që kufizon konkurrencën pasi që, në këtë rast ka larmi të shërbimeve të akomodimit si dhe të çmimeve që ofrojnë shërbimet hoteliere.

Ky konkluzion hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të iniciojë konfliktin administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

AUTORITETI I KONKURENCËS

Komisioni

Neime Binaku-Isufi

Kryetare



Kaltrina Sela

Nafije Osdautaj

Salihe Gashi-Loku


Florent Mehmeti

Nënkryetare

Anëtare

Anëtare

Anëtar



Me këtë KONKLuzion njoftohen:

- *Hostel Oda sh.p.k;*
- *Arkiva;*